



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 31.05.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Diskutimi i Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese

2. Shqyrtimi i rasti për kandidat të tërhequr nga kandidimi për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

4. Kërkesa dhe ankime administrative të kandidatëve në procedurë verifikimi.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit,
2. Nejla Peka, përfaqësuese e autorizuar e Avokatit të Popullit.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni 232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

Në pjesën e parë të mbledhjes, për Pikën 1 të Rendit të Ditës, marrin pjesë, si të ftuar, edhe përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED:

1. Agnes Bernard, shefe e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS.
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon se anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku sipas njoftimit, është e angazhuar në një veprimtari zyrtare tjetër të rëndësishme dhe nëse përfundon në kohë do të paraqitet për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi i Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese

Shqyrtimi i rasti për kandidat të tërhequr nga kandidimi për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

Kërkesa dhe ankime administrative të kandidatëve në procedurë verifikimi.

Ardian Dvorani informon Këshillin se ka edhe një kërkesë përcjellë me email nga Avokati i Popullit që i kërkon Këshillit të konsiderojë edhe njëherë diskutimin mbi rregullat e funksionit të KED dhe akteve normative nënligjore të tij në këndvështrimin e transparencës, sipas nenit 233 të ligjit nr. 115/2015 lidhur me rolin dhe veprimtarinë Avokatit të Popullit në veprimtarinë e Këshillit.

Këshilli vlerësoj të vijojë mbledhjen me dëgjimin e kërkesës së parashtruar paraprakisht nga Avokati i Popullit.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se kërkesën e kam qoftë lidhur me vendimmarrjen e mëparshme të Këshillit dhe qëndrimin që unë kam dhe që nëse do të vazhdohet me të njëjtat rregulla do të kërkoj që ky qëndrimi im të shënohet në vendimet e KED ne lidhje

me paligjshmërinë e dhomës së këshillimit. Kjo është sot e tutje, por nuk dua që të cenohet në një mënyrë ose në një tjetër besimi i qytetarëve tek reforma në drejtësi. Prandaj kërkoj edhe një herë vëmendjen e Këshillit për këtë vendimmarrje. Së dyti, në lidhje me kontrollin që ne kemi për sa i përket e veprimtarisë së Këshillit dhe se si realizohet ky kontroll. Nuk e di nëse anëtarët janë në dijeni apo jo, por unë duhet të kërkoj vetë dhe të interesohem se kur ishin datat e gjyqit të kandidatëve me Këshillin dhe të shkoja vetë në seancë. Ky lloj informacioni besoj së duhet të shkëmbehet me persona të cilët për të verifikuar procesin duhet të jenë në seanca. Nuk është se ju nuk na keni dhënë informacion nëse unë e kërkoj, por besoj që ky është informacion duhet të ndahet me anëtarët e Këshillit dhe duhet të ndahet edhe diskutimi i bërë nëpër këto mbledhje sepse mund të na bjerë si *boomerang* nesër. Në fakt kur vajta në seancën e z. Kristaq Traja, kuptova një realitet tjetër. Ai pretendonte një realitet tjetër nga ai që ne dinim në vendimmarrje. Ndoshta do të ishte mirë që këto gjera të na referohen. Ai nuk pretendonte që nuk e kishte dorëzuar p.sh. fare deklaratën siç mendonim ne sepse ka kërkuar kohë për këtë shkak. Ai thotë e kam dorëzuar deklaratën për veten time por kam kërkuar kohe për dy djemtë. Pra ne nuk na ka dalë kjo në asnjë moment të hetimit dhe sigurisht që këto gjera duhet ti dijë secili prej nesh. Ajo mund të jetë një pretendim i pavërtetë. Por dua të them se cili ishte pretendimi dhe qëndrimi. Mos ndoshta duhet të kemi në vëmendje dhe në kuadër të informimit edhe zhvillimet e seancave gjyqësore, si ecin dhe ku mund të jenë problemet për ta rregulluar punën e Këshillit në të ardhmen. Sepse qëndrimet e vetë kandidatëve apo pikëpamjet e tyre dhe pikëpyetjet që ato kanë do të duhet që të paktën ti, dmth ky Këshill, ti marrë në vëmendje. Pastaj se si do të vendosen, si do të ecin çështja procedurale është një gjë tjetër. Dhe jo vetëm kaq por në padi thoshte që ju e keni pranuar vetë që unë e kam dorëzuar deklaratën dhe referonte një pikë të vendimit tonë, i cili nga një gjyqtar që nuk ka qenë pjese e sistemit, ngrinte pikëpyetje dhe unë do të doja që këto gjera ne ti diskutonim në një moment për të garantuar vendimmarrje transparente këtij Këshilli në atë mase që është e mundur të garantohet në kuptim dhe në përputhje me ligjin. Por nuk besoj se Këshilli duhet të rrije i mbyllur në një klauzolë dhe të mos kuptojë se çfarë ndodh. Nuk e di nëse e keni këtë informacion z. Kryetar, por dua të ndaj me ju. Mua nuk më ka ardhur nga ana juaj dhe përfaqësuesi i KED se cili ka qenë qëndrimi, cili ka qenë pretendimi i palës dhe unë gjeta me vend që ta ndaj me juve dhe me anëtarët e tjerë.

Ardian Dvorani informon se, në rradhë të parë padia është rrezuar. Ka shumë rëndësi kjo sepse është rrezuar për gjitha këto pretendime në dijeninë e time dhe e dyta vendimet tona i referohen akteve zyrtare. Ndërsa çfarë ka komunikuar zotëria me ILDKPI ne nuk e dimë. Ne jemi në dijeni të komunikimit zyrtar. Unë i shqyrtova pretendimet e tij të cilat ishin të pamaterializuara në asnjë provë. Kjo është të paktën që dukej nga procesi. Sigurisht më vjen keq

që një kandidature si zoti Traja u ndalua, por kjo ska të bëjë fare me Këshillin. Kjo ka të bëjë me një proces tek i cili ai nuk arriti të përmbushë një kusht ligjor, në komunikimin formal ligjor e procedural me një institucion që ligji e ka autorizuar ti verifikojë atë kriter e që është ILDKP. Të paktën mua kështu më rezulton. Mos ti zmadhojmë gjërat sepse mua nuk më rezulton kështu. Atëherë nëse ju thoni këtë gjë le të presim të zbardhet vendimi i gjykatës dhe çfarë thotë vendimi. Tani ne e dimë që në procese pretendohen shumë gjera por që nuk qëndrojnë. Edhe mua mu referua pa baza avokati pretendonte shumë gjera të tjera. Do ta presim vendimin e zbardhur.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se juve si kryetar besoj që duhet ti referoni gjithë Këshillit. Kjo është pjesë e veprimtarisë së Këshillit që unë kam të drejtë të mbikqyr sipas ligjit pavarësisht mbledhjeve. Mbledhja është gjë tjetër dhe kjo është gjë tjetër. Nëse ju mendoni se nuk duhet ta dijë asnjëri çfarë ndodh nëpër gjyqe përveç jush e që vetëm tek ju duhet të referohen këshilltarët e tjerë ne kemi bindje të ndryshme, lexim ndryshe të ligjit. Kjo mund të na çojë në konflikte në Gjykatën Administrative që të marrim secili kompetencën e vet. Po unë kam të drejtë ta them këtë gjë. Argumenti që thotë z Traja ka qenë tërësisht argumenti që ju keni bërë vetë në KPK për marrëdhënien me ILDKPKI. Unë nuk e kam fare problem. Unë them nuk jemi informuar, ju nuk keni informuar për vendimin. Në radhë të parë unë nuk jam informuar për rolin e të qenit personalisht në pozicionin vëzhgueses pastaj vendimmarrja sigurisht ju takon ju. A duhet të kem informim apo jo këtë gjë jam duke ndarë unë, nuk them në asnjë rast që kjo është vendimmarrje jo e drejtë. Për sa i përket faktit nëse e ka rrezuar apo jo gjykata një pretendim të caktuar, ky është një standard që ne po bëjmë një reformë të tërë në drejtësi se gjykatat shqiptare nuk kanë dhënë vendimet që duheshin. Nuk e kam për rastin konkret. Në rastin konkret unë nuk mendoj që kemi pasur ndonjë gabim, pro faktet duhen të sqarohen. Pra ne duhet të kuptojmë, hetojmë pak më thellë për të sqaruar faktet që të mos na dalin në boomerang. Ky fakt, ky pretendim është ngritur prej tij dhe ju sigurisht besoj e dini nga këshilltari i cili ka qenë dhe ka përfaqësuar në gjyq KED-në. A duhet ta dijë e gjithë KED apo duhet ta dini vetëm ju, ky është një problem tjetër.

Ardian Dvorani informon se unë nuk dua të hyj në detaje. Por e para njëherë që ishte procesi gjyqësor për z.Trajën jemi në dijeni të gjithë edhe mbaj mend e kemi thënë dhe në mbledhjen e kaluar. Tani ju mendoni që në mbledhjen e Këshillit do të miratohet se çfarë qëndrimesh dhe pretendimesh do të paraqesim ne aty në gjyq? Ju nuk me lejuat fare të informoj. Sepse edhe sot kemi një proces tjetër. Ky ishte një informacion që do e thoja në fund.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se keni informuar për padi por jo për datën e seancës. Në kuadër të mbikëqyrjes së veprimtarisë së KED, në momentin që ju emëroni një

person për ta përfaqësuar Këshillin në një proces gjyqësore, gjykoj unë është me vlere që të njoftoni, përveç njoftimeve të mbledhjeve edhe aktivitetet e KED-së. Veprimtaria nuk është vetëm mbledhje. Këtë e thotë ligji qartësisht. Mund ta kishit dërguar me email duke thënë kjo është seanca secilit prej anëtareve të KED-së dhe secili prej anëtareve të KED mund të shkojë të marri pjesë, mund dojë të dëgjojë. Kur them të shkojmë të dëgjojmë qëndrimet e kandidateve është më mirë për të gjithë Këshillin dhe për mua si vëzhguese që të adresojmë punën që duhet në kuadër të rritjes së besimit të qytetareve tek ky organ edhe tek drejtësia në përgjithësi. Sot në 9.30 ka qenë seanca tjetër. Unë kam dërguar një njëri atje për të dëgjuar seancën e z. Bendo. Por është çështja e shpërndarjes së informacionit. Nëse realisht pretendimet e z. Traja, që unë i mora vesh vetëm aty, ishin vërtetë shumë të pakuptimta, jepej një vizion krejt tjetër.

Ardian Dvorani informon se edhe unë mendoj që ishin të pakuptimta pretendimet e tij. Por ky është një vështrim dhe problemi i tij. Ai ka paraqitur disa pretendime edhe ne kemi bërë disa prapësime. Të presim dhe të shohim vendimin e zbaridhur të gjykatës dhe do të shohim çfarë ka pranuar gjykata.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se do paraqes kërkesë pranë Këshillit, në mënyrë që të kisha një kopje, në kuadër të transparencës dhe të të drejtës që unë kam në ligj, të marrja një kopje të të gjitha padive që vijnë në KED, duke qenë se jam vëzhguese edhe për veprimtarinë. Vetëm me mbledhjet nuk përmbillet veprimtaria e vëzhguesit

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se u njoha dhe me kërkesën e Avokatit të Popullit dërguar me email tek të gjithë anëtarët e Këshillit, e cila kërkon risjelljen në diskutim të pjesëmarrjes në të gjithë veprimtarinë e këshillit të Avokatit të Popullit, një e drejte kjo e cila është kufizuar në dy akte, me vendimin nr. 4 dhe vendimin nr.5 të Këshillit. Si përfaqësues i Presidentit të Republikës së Shqipërisë e kam mbështetur gjithmonë këtë kërkesë të Avokatit të Popullit. E kam kërkuar edhe vete që Këshilli duhet të hyjë thellë në diskutimin e kësaj çështjeje për të ndryshuar qëndrimin e tij krahasuar edhe me një vendim të mëparshëm, të parin, të marrë nga Këshilli me prezencën e të gjithë anëtareve të Këshillit, të 7 anëtarëve. Dhe kjo duhet të kthehet në diskutim në tryezën këtij Këshilli, në këtë mbledhje apo mbledhjen pasardhëse. Sepse po jemi tashmë nuk do të thosha në gjendje konfliktuale, por nga fjalët e Avokatit të Popullit ekziston mundësia për ngritjen e një padie administrative kundrejt aktit dhe kjo nuk do ishte fare e mirë. Kam edhe një çështje tjetër parimore persa i takon Metodologjisë. Në fakt, unë shqyrtova të gjitha mendimet e anëtarëve, kam parë edhe përmbajtjen e raportit të monitorimit të Komisionit të Pavarur në Kuvend dhe në thelb është pak a shume i njëjti qëndrim si i z.Roshi. Kërkimi që ka ky Komision Monitorimi mbi Metodologjinë lidhet me trajtimin e saj në raport me aktin normativ që jep klasifikimin që ka bërë vetë Këshilli me vendimin nr.5. Duhet të

mbahet në vëmendje ky raport i Komisionit të Monitorimit gjatë shqyrtimit të kësaj Metodologjie, mbi statusin e Metodologjisë.

Në pjesën e dytë të mbledhjes janë ndalimet nga kandidimi ku neve aty kemi një qëndrim parimor. Në lidhje me momentin e lejimit dhe ndalimit, si edhe e kam kuptuar unë në dy mbledhjet e tjera të mëparshme, Këshilli duhet të mbaj qëndrim edhe mbi statusin apo gjendjen procedurale të procesit të rivlerësimit kalimtar. Ka kandidatura që vijnë nga gjyqësori apo që janë të përfshirë në sistem. Mu desh të bëja një këqyrje personalisht vetë të gjithë akteve nënligjore të institucioneve aktuale të ngritura të sistemit të drejtësisë, vendimeve të KLP për zgjedhjen dhe procedurat për Prokurorin e Përgjithshme, vendimin dhe rregulloret e KLP për përzgjedhjen e prokurorëve të SPAK, vendimet e KLGJ-së për zgjedhjen e anëtarëve që shkojnë në Gjykate të Lartë në promovim apo te gjyqtarëve të tjerë të gjykatës se posaçme. Më rezultoi një qëndrim i pandikuar në të tërë organet. Ndërkohë që KLP merr për bazë dhe përfshin në kandidim vetëm ata kandidatë që janë pjesë gjyqësorit apo ato që përshihen në procesin rivlerësimit kalimtar vetëm me vendim të formës së prerë. Këtu në Këshill kemi 2 anëtarë të tij që kandidojnë për Prokuror i Përgjithshëm dhe që i nënshtrohen atyre akteve. Ndërkohë që KLGJ ka një tjetër standard. Përdor për gjykatën SPAK te njëjtin standard me prokurorinë, me KLP-në. Për raste të tjera i kërkon KPK të për të kryer procedurat e rivlerësimit kalimtar me përparësi dhe nëse nuk shprehn brenda 3 muajve i kryejnë vetë procedurat e verifikimit të kandidatëve. Pra kandidatët duhet patjetër të kenë kaluar me vendim të formës së prerë ndërsa për gjyqtarët e tjerë shkon me vendimin e KPK-së. Ndërkohë që Këshillit është në standardin më të ulët krahasuar me këto dy insitucione. Prandaj e gjej me vend që Këshilli duhet ta rikthejë në diskutim këtë çështje përpara se të futet në ndalime, duke aplikuar normën që është e parashikuar me akte nënligjore të tij. Për të theksuar edhe njëherë qëndrimin dhe për të parë përfundimisht a konsiderohet kandidat i kualifikuar me vendim jo të formës së prerë që sipas Kushtetutës gjyqtarët e shkarkuar pezullohen dhe paguhen 75 % apo me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Krahasuar me standardin për Prokurorin e Përgjithshëm dhe kandidatët për SPAK , për Gjykatën Kushtetuese nuk është se niveli i gjyqtarëve kushtetues është më i vogël. Kështu që unë e shikoj shqetësuese këtë çështje, e sjell në vëmendje të Këshillit përpara se të kalojmë në pjesën e dytë të kësaj mbledhje ku diskutohen edhe dy kandidatura për ndalim një me vendim të formës së prerë dhe një me vendim të shkallës së parë. Jam institucion që përfaqësoj një nga organet e emërtesës, imagjinoni një kandidat të pranuar e më pas të shkarkuar.

Mbi pyetjen e Avokatit të Popullit lidhur me kohën se kur janë shpallur nga ana e Kuvendit dhe Presidentit të RSH vendet vakante për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese **Bledar Dervishaj** shpjegohet se për vakancat e Presidentit, kemi dy vakanca të shpallura njëkohësisht në

7 shkurt 2018. E para ishte rasti i z. Sokol Berberi i cili kishte 6 muaj që i kishte përfunduar mandati. E dyta ka ardhur për shkak të dorëheqjes së z. Besnik Imeraj, e cila ishte konfirmuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa vakanca e znj. Altina Xhoxhaj kur ka marrë vendimi formë të prerë nga KPA diçka 15 dite më pas është shpallur vakanca. Kur ky përfundoi, është shpallur vakanca për mandat të plotë.

Mimoza Arbi shpjegohet se në datën 12.02.2018 është bërë shpallja për rastin e z. Vladimir Kristo që ka dhënë dorëheqjen. Ndërsa në rastin e z. Fatos Lulo është bërë shpallja në datën 28.08.2018 pasi ishte rrëzuar nga organet e rivlerësimit kalimtar në të dy shkallët. Në rastin e z. Bashkim Dedja shpallja e vendit vakant nga Kuvendi është bërë në momentin kur KPA pranoi kërkesën e Komisionerit Publik, pra është bërë pas vendimi të formës së prerë.

Ardian Dvorani, në lidhje me kërkesën për të ridiskutuar dhe eventualisht vendosur me të gjithë përbërjen e KED rregullat e vendosura me aktet nënligjore normative informon se për momentin nuk janë në mbledhje të shtatë anëtarët në kushtet kur mungon znj. Arta Marku. Prandaj sugjerohet të vijohet njëherë me çështjet e parashikuara në rendin e ditës. Pika e parë është vijimi i diskutimit mbi Metodologjinë e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjen e kandidatëve në Gjykatën Kushtetuese.

Këshilli vendosi të vijojë mbledhjen me diskutimin e pikës së parë të rendit të ditës për diskutimin mbi Metodologjinë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese, duke pasur parasysh diskutimet dhe dakordësitë e arritura në mbledhjet e mëparshme, mendimet me shkrim që kanë paraqitur një pjesë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhjet e Këshillit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë fillimisht mes tyre edhe një herë nëse kjo Metodologji ka ose jo natyrën e një akti nënligjor normative e përrjedhë të jetë anekt tjetër i vendimit normative nr.5/2019 të KED apo ka natyrën e një dokumenti shpjegues për efekt të transparencës dhe orientimit të kandidatëve në pritshmëritë e tyre të vlerësimit me pikë të kandidaturës. Në përfundim të shkëmbimit të mendimeve u dakordësua që, ndonëse synimi nuk është për të bërë një akt tjetër normativ por një dokument pune shpjegues dhe orientues për vetën anëtarët e KED dhe për të qenë transparent me të gjithë mbi mënyrën se si KED do të procedojë me caktimin e pikëve për çdo kriter vlerësues e duke u kujdesur për të mos përcaktuar element që tejkalojnë ligjin apo aktet normative të KED, një qëndrim përfundimtar mund të mbahet kur të mbarojë diskutimi dhe miratimi me vendim të KED të kësaj Metodologjie.

Në vijim, mbi bazën e projektdokumentit dhe mendimeve me shkrim të shkëmbyera paraprakisht mes tyre, **anëtarët e Këshillit** diskutojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit të kriterit vlerësues të vjetësisë në profesion, e caktuar me akt normativ në maksimum 4 pikë. Ndërmjet

variantëve të debatuar u arrit në përfundimin që vlerësimi me pike për këtë kriter të fillojë nga minimumi i vjetërsisë në profesion i përcaktuar nga ligji, pra nga 15 vjet vjetërsi, i ndarë në 4 periudha, ku për secilën shtohet 1 pikë (15-19)(mbi 19 -23)(mbi 23-27) (mbi 27 vjet), duke pasur parasysh këtu, ndërmjet të tjerave vlerën që shton objektivisht kohëzgjatja e vjetërsisë në profesion dhe nga an tjetër mospërrjashtimin nga maksimumi i pikëve në vlerësim të kandidatëve që kanë filluar ushtrimin e profesionit pas vitit 1990.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se kjo është një nga ato pikat që kemi pasur goxha diskutim. Unë besoj se nuk mundet të mos japim asnjë pikë njerëzve të cilët kanë pasur 15 vjet në profesion. Vërtet ai është kriter vlerësues dhe kriter kualifikues, por nuk përcaktohet kërkuar që nuk vlerësohesh. Këto 4 pikë mund të jenë të rëndësishme. Është vërtetë shumë e vështirë tani për të mbledhur shumë pikë. Kandidatet që ne po kërkojmë gati gati nuk ekzistojnë dmth lidhur me disa kriteret që jemi duke i bërë. Dhe në këtë këndvështrim mendoj që nuk është e përshtatshme të heqim edhe këto pikët për sa i përket njerëzve që pas 20 viteve e kanë eksperiencën e mjaftueshme për të ushtruar një profesion, duke ua humbur edhe atyre mundësinë e pikëve dhe duke ua dhënë atyre që kanë 30 vjet. Do të mendoja që këto 4 pikë të shpërndahen në një afat prej 10 vitesh sepse realisht bën një ndryshim të rëndësishëm Për 10 vjet njeriu hyn në Gjykatën e Lartë dhe mbaron tek Gjykata e Lartë dhe eksperience më të madhe se sa kjo nuk mund të këtë marrë në jetë, psh. Për hir të së vërtetës ky do ishte sugjerimi im, pra që të paktën Këshilli në këtë kriter do të duhet që të vlerësonte eksperiencën profesionale, të vlerësonte edhe juristët e tillë që kur ke 15 je e afirmuar nuk je më as jurist i ri.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me diskutimet mes tyre lidhur me mënyrën e pikëzimit të kriterit vlerësues të historikut arsimor, i caktuar me akt normativ në maksimum 2 pikë. Nga diskutimi qëndrimi i përbashkët është që orientimi të jetë vlerësim me 1 pikë për notë mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë për notë mesatare mbi 9. Në lidhje me kandidatët që janë arsimuar jashtë vendit, në parim, për përcaktimin e notës mesatare të përputhshme me këtë notë në Republikën e Shqipërisë Këshilli do të orientohet që të mbështetet në konvertimin individual të rezultateve të arsimimit të kandidatit jashtë vendit nga Ministria e Arsimit dhe metodikat që ajo zbaton për këtë qëllim. Nuk vlerësohen të mjaftueshme argumentet e relatorit dhe disa prej anëtarëve për të mundësuar përcaktimin e një notë mesatare të ponderuar edhe deri në një nivel të caktuar poshtë notës mesatare 8 nga vetë Këshilli për kandidatët që janë arsimuar jashtë vendit, veçanërisht nisur nga shteti apo lloji i shkollës së lartë të ndjekur nga kandidatët.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se sa i përket çështjes se notës po i referohem nenit 7/a të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese mbi kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i cili përcakton katër kushte. Më tej përcakton se kandidati

duhet të plotësojë edhe këto kritere. Edhe për këto përcakton që duhet ti plotësojë, por nuk thotë që ai vlerësohet për këto kritere. Dhe në fund vijnë treguesit shkencore ku përfshihen botime, artikuj dhe ecuria gjatë arsimit me një mesatare të notave jo me pak se 8. Pra nëse nuk e ka 8 ose të barazvlefshme me të nuk mund ta marrim në konsiderate sepse ligji thotë që duhet ta plotësojë këtë kriter që është kriter kualifikues. Ligji përcakton nëse nuk e ka 8 ose të barazvlefshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendi ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës. Lidhur me përcaktimin e barazvlefshme me të do të na duhet të kemi gjithmonë një mendim të një specialisti të ministrisë. Në gjykimin tim duhen vlerësuar edhe studentet që kanë mbaruar studimet jashtë me një qasje pak më pozitive sepse duam të thithim në sistem edhe këtë grup të rinjsh, në mos të rinjsh studiuesish sepse nuk mund të jenë me të rinj me eksperiencë 15 vjet, të cilët kanë kryer jashtë vendit për të pasur dhe një rritje sigurisht të performancës. Por duhet të përjashtojmë këtu studimet e kryera jashtë, dhe këtë mund ta bëjmë në Metodologji, të cilat nuk njihen nga Ministria e Arsimit si studime të vlefshme për tu konvaliduar. Kemi një serë vendesh në të cilat, p.sh. bonusi prej 10000 lekësh u jepet të gjithëve për tituj shkencore por nuk jepet nëse nuk ke mbaruar në disa vende të caktuara. Pra duhet të bëjmë edhe këtu një lloj kriteri që janë vendet e OECD-së, nuk e di se si është e përcaktuar në ligj. Prandaj edhe nëse do të përmbaheshim pak a shumë të njëjtit kriter për sa i përket faktit se ku do konsiderohen fakultetet e kryera për të marrë këto pikë më tepër, nëse bëjmë një kriter besoj se do të ishte më e saktë. Por jam dakord të këtë një lloj diferencimi.

Mimoza Arbi kërkon fjalën dhe parashtron se në lidhje me kandidatët që kanë kryer studimet jashtë vendit detyrimisht në dokumentet e paraqitur pranë KED duhet të kënë sjellë diplomën e konvertuar. Aty duhet të jetë edhe konvertimi i notave, mbi bazën e të cilit referenca do të jetë tek nota mesatare 8. Pra, siç është për atë që kanë mbaruar studimet e larta apo master në universitetet shqiptare apo private. Përderisa është bërë ky konvertim do të referohemi nenit 7 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese që përcakton si kriter bazë mesataren 8. Mbi këtë fillon edhe pikëzimi për notën 8-9 me 1 pikë dhe mbi 9 në notën maksimale 10 me 2 pikë. Megjithatë, për të marrë KED një informacion më të plotë mund të dërgojë një shkresë e njësisë përkatëse të Ministrisë së Arsimit. Ata i kanë të përcaktuara edhe nivelet e universiteteve, si p.sh ato që janë tepër cilësore siç mund të jetë Harvard-i. Nuk mund të barazohet një note mesatare 7 tek Harvardi me një note 9 në Universitetin e Tiranës. Ajo që nuk duhet shkelur është ajo që është përcaktuar në ligj, pikërisht tavanin e notës.

Anëtarët e Këshillit, lidhur me mënyrën e pikëzimit të kriterit vlerësues të historikut arsimor, diskutojnë edhe nëse vlerësimi i notës mesatare të arritur në Shkollën e Magjistraturës duhet të përfshihet në këtë kriter apo në grupkriteret vijuese mbi Kualifikimet Pasuniversitare,

titujt dhe gradat shkencore. Pas diskutimit u vlerësua që për këtë moment ,sikurse edhe për problematikat e debatuar mbi kriterin e notës mesatare të konvertuar për arsimim jashtë vendit, të mbahet qëndrim përfundimtar pas konsultimeve me ekspertë të fushës nga Ministria e Arsimit.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me diskutimet mes tyre lidhur me orientimet dhe shpjegimet për grupkriteret vlerësuese të përfshira në “Kualifikime Pasuniversitare”, e caktuar me akt normativ në maksimum 8 pikë. Anëtarët diskutojnë për mënyrën e shpjegimit dhe pikëzimit të përfundimit të Shkollës së Magjistraturës nisur nga përcaktimet ligjore dhe konkludojnë në parim se mund të jemi përpara një specializimi afatgjatë, pjesë e programeve të ciklit të tretë të studimeve pasuniversitare, duke pasur parasysh që dispozitat kalimtare të ligjit për Arsimin e Lartë e përcaktojnë këtë në mënyrë të shprehur. Gjithashtu përfundimi i kësaj Shkollë të mos vlerësohet në pikë më shumë se sa fitimi i një grade shkencore sipas ligjit. Në lidhje me shpërndarjen e pikëve brenda totalit maksimal prej 8 pikësh për grupkriteret “Kualifikimet Pasuniversitare” në raportin 5-3 ose 6-2 ndërmjet kualifikimeve pasuniversitare dhe trainimeve të tjera. Gjithashtu, anëtarët dëkordësohet për të pasur një diferencë në pikëzime ndërmjet titujve akademikë dhe gradave shkencore të fituara brenda apo jashtë vendit.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me diskutimet mbi grupkriteret “Kualifikime Pasuniversitare” për mënyrën e shpërndarjes dhe të shpjegimit të pikëve konkrete që caktohen për titujt akademikë dhe gradat shkencore, si edhe për rastet dhe mënyrën e vlerësimit në pikë të trainimeve të tjera të kryera nga kandidatët duke mënjanuar mbivendosjen me pjesëmarrjen në veprimtari të tilla që lidhen me vetë procedurat dhe detyrimet përkatëse të kandidatit në kuadër të plotësimit të kushteve për të fituar gradën shkencore po titullin akademik.

Nejla Peka përfaqësuese e Avokatit të Popullit, kërkon fjalën dhe parashtron se sjell në vëmendjen tuaj që nëse flasim për Metodologji vlerësimi dhe nëse flasim lidhur me dallimin ndërmjet një trajnimit pasuniversitar ose kualifikimi, jo 2 javë por edhe 2 javë e më lart, dhe doktoraturës, duhet të jemi pak të kujdesshëm. Duke iu referuar Ligjit për Arsimin e Lartë, ky ligj ka përcaktuar në një dispozitë të posaçme, neni 82, se sa kohë i duhet një kandidati që ndjek ciklin e 3-të të studimeve të doktoraturës për të përfunduar një studim doktrate. Është minimalisht 3 vjet dhe maksimalisht 5 vjet. Përpos kësaj, ka përcaktuar edhe të gjitha detyrimet ligjore që shlyen kandidati për doktorant. Ka dhënie leksionesh, publikimet shkencore, pra nuk mund të barazohet në fakt një trajnim qoftë ky edhe 6 mujor apo 1 vit, më një shkollë doktrature, është shkollë. Dhe përpos është edhe punë e pavaruar, kërkimore shkencore, e cila

rregullohet në ligjin për kërkimet shkencore. Ndërmjet një kualifikimi pas universitar dhe doktoratës mos të ketë shenjë barazie. Mund të ketë raste që kanë mbaruar, kanë marrë gradën doktor dhe kanë vijuar punën kërkimore shkencore edhe në bazë të ligjit për arsimin e lartë, që bënë një trajnim maksimumi deri në 1 vit. Në lidhje me diskutimin për vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës ligji parashikon se kanë të drejtë të aplikojnë për në Gjykatë Kushtetuese, individ brenda sistemit që nënkupton në këtë rast të qenit magjistratë, si edhe nga jashtë sistemit. Të mbajmë parasysh parimin e mosdiskriminimit. Ligji përcakton që të qenit magjistratë nuk është cilësi e posaçme, por është shkollë dhe për këtë ti vlerësohesh për të hyrë në garë, pra jo si cilësi kualifikuese që e spikat njërin kandidat nga tjetri.

Anëtarët e Këshillit vijojnë të diskutojnë për shpjegimin orientues dhe mënyrën e caktimit të pikëve për kriterin vlerësues “Trainime ë tjera”, për të cilat Këshilli gjykon se mund të caktohen në maksimum 2 ose 3 pikë. Në këtë proces Këshilli do të orientohet nga kohëzgjatja e trainimit, paraqitja e certifikatave vlerësuese për njohuritë e fituara, tematikën e trainimit apo vendin dhe institucionin ku janë kryer trainimet.

Në përfundim të diskutimeve të kësaj mbledhjeje anëtarët e Këshillit vlerësuan që deri në mbledhjen e ardhshme të realizohen takime dhe këshillime me ekspertë të Ministrisë së Arsimit për të qartësuar problematikat që rezultuan në lidhje me konvertimin e notës mesatare, njohjen e diplomave dhe gradave shkencore të fituara jashtë vendit, vlerën dhe natyrën e gradave shkencore, titujve akademikë, specializimeve afatgjata, përfshirë përfundimin e Shkollës së Magjistraturës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve, duke njoftuar se në mbledhjen e ardhshme që do të zhvillohet në varësi të konsultimeve me Ministrinë e Arsimit me diskutimin mbi Metodologjinë dhe shqyrtimin e çështjeve të tjera që nuk ishte e mundur të trajtoheshin në mbledhjen e sotme, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 12.55

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Redjona MYRTJA

Dorina DULAJ

KRYETARI

Ardian DVORANI